



Npi – 01/35 datë: 05.03.2026

Bazuar në nenet 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenet 34 dhe 40 të Statutit të Komunës së Shtimes, Nr.01-06/1636 të datës 03.09.2008; Nenet 3, 7, 8 dhe 9 të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë; Kuvendi Komunës së Shtimes në seancën e parë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më: 05.03.2026 miratoi:

**V E N D I M**  
PËR ZGJEDHJEN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

**I**

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e parë të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më datën: 05.03.2026, unanimisht miratoi Vendimin për zgjedhjen e Komitetit për Komunitete në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi i Komitetit	Përfaqësimi Politik
1	Artan Lubovci	Anëtar i KPK nga Kuvendi	LVV
2	Fatlinda Rrafshi	Anëtare e KPK nga Kuvendi	PKD
3	Haqif Arifi	Anëtar i KPK nga Kuvendi	LDK
4	Bajram Ilazi	Anëtar i KPK nga komuniteti Ashkali	OJQ (VOR)
5	Gyltene Osmani-Ilazi	Anëtare e KPK nga komuniteti Ashkali	PSA
6	Sabrie Veliu	Anëtare e KPK nga komuniteti Ashkali	OJQ (Art Stars)
7	Rrahman Kadrija	Anëtar i KPK nga komuniteti Ashkali	PAI

**II**

A r s y e t i m:

- Tre anëtarët e parë të KPK sipas kësaj table (1-3), që njëkohësisht janë edhe anëtar të Kuvendit, janë zgjedhur nga Kuvendi unanimisht me vota të hapura.
- Për katër anëtarët e KPK sipas kësaj table (4-7) që vijnë propozimet nga Komuniteti pakicë (e që nuk janë anëtar të Kuvendit), Kuvendi ka vendosur që të bëjë përzgjedhjen e tyre me vota të fshefta, meqenëse kishte 6 propozime të paraqitura si kandidat konkures.
- Në raundin e parë të votimit kandidatët kanë fituar këto vota: 1. Arton Demiri (Komuniteti Rom) – 12 vota, 2. Arjeta Maliqi (Kom. Egjiptian) – 10 vota, 3. Sabrije Veliu (Kom. Ashkali) – 13 vota, 4. Bajram Ilazi (Kom. Ashkali) – 15 vota, 5. Rrahman Kadrija (Kom. Ashkali) – 12 vota, dhe 6. Gyltene Osmani-Ilazi (Kom. Ashkali) – 18 vota.
- Fituesit e raundit të parë ishin:
  1. Gyltene Osmani-Ilazi (Kom. Ashkali) – 18 vota,
  2. Bajram Ilazi (Kom. Ashkali) – 15 vota,
  3. Sabrije Veliu (Kom. Ashkali) – 13 vota.
- Kuvendi ka organizuar raundin e dytë të votimit për arsye të votave të barabarta të kandidatëve, Arton Demiri dhe Rrahman Kadrija, me nga 12 vota.
- Në raundin e dytë fitues ka dalë Rrahman Kadrija (Komuniteti Ashkali) me 11 vota, ndërkaq kandidati Arton Demiri (Komuniteti Rom) i ka fituar 10 vota.

**III**

Vendimi hynë në fuqi 30 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

**IV**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Antarëve të Komitetit, Kryesuesit të Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyres për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit  
Rrahman Jakupi